



**Klan Kosova
Baton Haxhiu
Drejtor
Prishtinë**

**Rasti Nr. 2019/24
Ref:1905/615/KPM/mf**

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2019/24-Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Klan Kosova (Palë përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) ka miratuar Kodin e Etikës KKPM-2016/03 për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovë, i cili ka hyrë në fuqi më 11 tetor 2016. Me Kodin e Etikës KKPM-2016/03 janë përcaktuar rregullat e sjelljes dhe të punës së shërbimeve mediale audiovizuale në pajtim me dispozitat ligjore që janë të domosdoshme në një shoqëri demokratike.
2. KPM me datë 17 prill 2019 ka pranuar një ankesë nga znj. Mirvete Spahija, të parashtruar nga avokati i saj z. Samir Rekaj, ndaj kronikës “*Babai ther me thikë të birin*”, të transmetuar nga pala përgjegjëse me datën 8 prill 2019 në edicionin e lajmeve qendrore të orës 20:00.
3. KPM me datën 17 prill 2019 përmes një shkrese e ka njoftuar Palën përgjegjëse lidhur me ankesën e pranuar nga Pala ankuese dhe ka kërkuar që brenda tre (3) ditësh të sjellë sqarim lidhur me pretendimet e ankesës.
4. KPM me datën 25 prill 2019 ka pranuar një përgjigje nga Pala përgjegjëse përmes së cilës theksohet se znj. Mirvete Spahija ka pranuar të flasë për televizionin e Palës përgjegjëse me kusht që të mos i zbulohet fytyra dhe identiteti. Gjatë gjithë kronikës fytyra e saj është mbajtur e fshehur, është prezantuar vetëm me initiale dhe ajo është pyetur edhe për filmimin brenda shtëpisë.
5. KPM me qëllim të vlerësimit të ankesës së Palës ankuese ka bërë monitorimin e kronikës së transmetuar në Palën përgjegjëse dhe ka analizuar përgjigjen e Palës përgjegjëse në lidhje me pretendimet ankimore të Palës ankuese. KPM bazuar në Raportin e monitorimit

ka gjetur se gjatë kësaj kronike është bërë e ditur për publikun se ngjarja ka ndodhur në Dardanë të Ferizajit, se në shtëpi ishte vetëm nëna e djalit N.S., e cila edhe është intervistuar e shtrirë në krevat.

6. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 26 prill 2019 i ka dërguar Palës përgjegjëse Njoftim për Shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Kodin e Etikës KKPM-2016/03, duke i ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh të ofrojë sqarimet për shkeljet e gjetura.
7. KPM me datën 10 maj 2019 ka pranuar një përgjigje të dytë nga Pala përgjegjëse përmes së cilës theksohet edhe një herë se znj. Mirvete Spahija ka pranuar të flasë për televizionin e Palës përgjegjëse për ta intervistuar, me kusht që të mos i zbulohet fytyra dhe identiteti. Gjatë gjithë kronikës fytyra e saj është mbajtur e fshehur, është prezantuar vetëm me iniciale dhe ajo është pyetur edhe për filmimin brenda shtëpisë.

Analiza Ligjore

8. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 8 të Kodit të Etikës për Ofruesit e Shërbimeve Mediale në Republikën e Kosovës KKPM 2016/03.
9. Bazuar në monitorimin që i është bërë kronikës së transmetuar me titull *“Babai ther me thikë të birin”*, është gjetur se Pala përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 1, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“E drejta e privatësisë së individëve duhet të respektohet. Ndërhyrja në çështjet thjeshtë private apo personale të cilat nuk kanë ndikim në interesin publik është e ndaluar. Ata që janë prekur nga tragjedia apo pikëllimi duhet të trajtohen me ndjeshmëri, respekt dhe maturi duke e respektuar privatësinë e plotë të tyre.”

KPM ka gjetur se Pala përgjegjëse ka raportuar të nesërmen për ngjarjen e rëndë të ndodhur në familjen e Palës ankuese, duke e incizuar gruan e sëmurë e të moshuar, të shtrirë në krevat, e cila sapo kishte përjetuar një ngjarje të rëndë, pa respekt dhe maturi se si do të ndikojë ajo intervistë në gjendjen shëndetësore dhe marrëdhëniet familjare të mëtutjeshme të saj.

10. Bazuar në Raportin e monitorimit KPM gjithashtu ka gjetur se Pala përgjegjëse ka vepruar edhe në kundërshtim me nenin 7, paragrafi 8, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03, i cili përcakton se:

“Rrëfimet për tragjeditë personale duhet të paraqiten me kujdes dhe mirëkuptim nga ana e OSHM-ve.”

KPM ka gjetur gjithashtu se Pala përgjegjëse ka dështuar të sigurojë trajtim me kujdes dhe mirëkuptim gjatë transmetimit të kronikës rreth Palës ankuese, e cila sapo kishte përjetuar tragjedi familjare.

11. KPM duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 7 paragrafi 1 dhe 8 të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.

Vendim

12. Pala përgjegjëse sanksionohet me Vërejtje në pajtim me nenin 30, paragrafi 1, të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 7, paragrafi 1 dhe 8, të Kodit të Etikës KKPM-2016/03.
13. Pala përgjegjëse obligohet që gjatë trajtimit të ngjarjeve të ngjashme të ketë kujdes të shtuar dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet në të ardhmen.

E drejta për Ankesë

14. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
15. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.


Muja FERATI
Kryetar



21. 05. 2019
Datë